e-Buletini mujor i Sekretariatit për Çështje Evropiane
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Tetor 2015

Raportuesi për Republikën e Maqedonisë në parlamentin Evropian, z. Ivo Vajgëll në takim në Sekretariatin për Çështje Evropiane

Zëvendëskryeministri Besimi, theksoi se integrimi euroatlantik mbetet prioritet strategjik kyç i vendit tonë, ndërsa Qeveria edhe më tej vazhdon me përpjekjet për zbatimin e reformave dhe masave të nevojshme për afrimin e mëtejmë ligjor dhe institucional të vendit kah Bashkimi Evropian. Diskutimi u përqendrua në aktivitetet e ndërmarra për zbatimin e reformave kyçe të agjendës evropiane në vend.
Eurodeputeti Vajgl, theksoi gatishmërinë e tij për mundësimin e kontributit të mëtejmë për përkrahje të bashkëpunimit dhe për procesin e reformave në vendin tonë, në aspekt të angazhimit të tij personal, dhe në aspekt të Parlamentit Evropian. Ai gjithashtu theksoi edhe nevojën e zbatimit të plotë të marrëveshjes së arritur politike. Më shumë

Takime në Bruksel në prag të raportit të progresit

Në takimet me drejtorin e Drejtorisë për Zgjerimin e BE-së, z. Kristian Danielson dhe me njeriun e parë të Sektorit për Maqedoninë në këtë drejtori, Zhan-Erik Pake, temë kryesore ishte raporti i ardhshëm i progresit.
Është e dukshme se pritjet në Bruksel janë të mëdha për Maqedoninë dhe për këtë vendi në mënyrë të obligueshme dhe efikase të punojë në zbatimin e marrëveshjes politike të 2 qershorit, bashkë me pakon e reformave të cilat duhet t'i bëjë vendi ynë.Qëllimi është që e gjithë kjo në mënyrë përkatëse të reflektohet në raportin e ardhshëm dhe Maqedonia të jetë para Këshillit Evropian me edhe një rekomandim për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE dhe me raport i cili do të japë rekomandime që në periudhën e ardhshme të realizohet agjenda për zgjerimin e BE-së me progresin e mëtejmë të reformave të pritura të cilat janë të rëndësishme për Republikën e Maqedonisë", theksoi Besimi në deklaratën e tij për MIA-n.Më shumë

Takime Bilaterale të Zëvendëskryeministrit Besimi

Takim me deputeten gjermane z. Gering

Në takim u bisedua për aktivitet dhe mundësitë e shtetit për ballafaqimin e numrit të madh me emigrantët si dhe për valën te cilën parashikohet që do të arrij, si dhe për masat qe ndërmiren nga ana jone. Besimi informoi për takimet koordinuese me zyrtarët e BE-së, dhe vendet donatore dhe organizatat në Republikën e Maqedonisë, ku një nga temat e diskutimit është migrimi dhe situata e tanishme.
Tema e bisedës në takim ishin edhe ngjarjet e fundit në vend në kontekstin e procesit të integrimit evropian, si dhe përmbushja e reformave të nevojshme dhe marrëveshjet politike.Më shumë

Takim me ambasadoren e Danimarkës z-nja Lisalote Plasner

Gjatë takimit Zëvendëskryeministri Besimi falënderoi për përkrahjen e vazhdueshme qe e jep Danimarka në procesin e integrimit Euro-Atlantik Republikës së Maqedonisë dhe të rajonit.
Danimarka është përkrahëse e procesit të zgjerimit të BE-së dhe mban qëndrimin se kusht për përparimin e vendeve duhet të jenë arritjet në përmbushjen e detyrimeve të nevojshme të secilit vend veçmas. ngjarjet e fundit në vend në kontekstin e procesit të integrimit evropian, si dhe përmbushja e reformave të nevojshme dhe marrëveshjet politike.Më shumë

Takim me z-nj Rene Xhouns Bos, zëvendës ministre për punë të jashtme të M. së Holandës

Gjatë takimit u theksua se Holanda është një ndër mbështetësit më të mëdhenj të Republikës së Maqedonisë në anëtarësimin e strukturave euroatlantike, dhe për të cilën është kyçe që Maqedonia të vazhdojë të japë rezultate të matura në zbatimin e reformave në fushat përkatëse. Në këtë kontekst u shqyrtua situata aktuale politike si dhe aktivitetet për realizimin e të gjitha prioriteteve reformuese. vend veçmas. ngjarjet e fundit në vend në kontekstin e procesit të

integrimit evropian, si dhe përmbushja e reformave të nevojshme dhe marrëveshjet politike.Më shume

Drejtori rajonal i UNICEF-it z. Mari Pjer Poarine në takim me udhëheqësin e SÇE-së



Në takim u bisedua për masat dhe aktivitet të cilat ndërmerren në vendin tonë në drejtim të ballafaqimit me krizën e refugjatëve dhe emigrantëve, si dhe për konkluzat e Samiti të mbajtur rreth kësaj çështjeje.
Zëvendëskryeministri Besimi, gjate takimit theksoi se Maqedonia bën gjithçka që është në mundësitë dhe kompetencat e saja, për të adresuar në mënyrë adekuate situatën, para së gjithash për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të emigrantëve, mbrojtjen e sigurisë nacionale dhe publike, mbrojtjen e shëndetit publik, e veçanërisht në drejtim të luftimit të kontrabandimit të emigrantëve dhe trafikimit me njerëz. Më shumë

Konferencë e Donatorëve për sfidën e refugjatëve e organizuar nga Sekretariati për Çështje Evropiane



Në takim u prezantuan planet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për menaxhimin e valës së migrantëve nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës. Gjithashtu, u prezantuan edhe vlerësime konkrete të nevojave, nga të cilat një pjesë tashmë sigurohet nga burimet dhe resurse të vendit, si dhe me mbështetjen e disa organizatave ndërkombëtare, aktive në këtë fushë.
Nga ana e përfaqësuesve të pranishëm të BE-së, vendet donatore dhe organizatat ndërkombëtare u përshëndet iniciativa e këtij lloji takimi. Në veçanti që e njëjta realizohet në prag të takimit të ministrave të BE-së në Luksemburg, në të cilën shqyrtohen plane konkrete të Unionit për menaxhimin e situatës. Më shumë

EU talks
Secretariat for European Affairs

"

Pritjet, Sfidat dhe Hapat e Ardhshme në Eurointegrime

"

Para shpalljes së Raportit të këtij viti nga ana e Komisionit Evropian Strategjia për zgjerim dhe Raporti i progresit për Republikën e Maqedonisë, sot në hapësirat e Sekretariatit për Çështje Evropiane, u realizua debat në temë: "Pritjet, sfidat dhe hapat e ardhshme në eurointegrime".



Debati i sotëm është pjesë e ciklit debatues "BE bisedime" në organizim të Sekretariatit për Çështje Evropiane, në drejtim të realizimit të BE Agjendës 2015, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të dialogut në procesin e aderimit në Bashkimin Evropian, e udhëhequr nga parimet inkluzive dhe transparente në punën e saj. n e situatës.Më shumë

Zbatimi i procesit reformues

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi Strategjinë për punësim për vitin 2016 - 2020, dokument gjithëpërfshirës me të cilën duhet të adresohen sfidat në fushën e punësimit të të rinjve, papunësia afatgjate përforcim në lidhje me arsimin dhe tregun e punës.

- U mbajt seminar për Program të reformave në punësim dhe politikë sociale për vendet kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, në organizim të Komisionit Evropian, në kuadër të Programit për reforma ekonomike (Economic Reform Programme - ERP).

  fushën e punësimit të të rinjve, papunësia afatgjate përforcim në lidhje me arsimin dhe tregun e punës.

IPA Projekte

Ngjarje promovuese e programit për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (GIZ RED): Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Rajonal përmes projekteve të qëndrueshme

Financuar nga: BE-ja

Qëllim i projektit: zbatim i suksesshëm i politikave për balancimin e zhvillimit rajonal, në përputhje me standardet e BE-së, si dhe kontribut i mëtutjeshëm në zvogëlimin e pabarazisë në vend, nëpërmjet përforcimit të qeverisjes rajonale dhe koordinim më të mirë të politikave.

Vlera e përgjithshme: 676.000 euro Më shumë

"Provomi i shërbimeve për përfshirje sociale"

Financuar nga: instrumenti përndihmë para-aderuese të BE-së (IPA)

Qëllim i projektit: përmirësim i sistemit, shërbimeve dhe kapaciteteve profesionale për përfshirje e burrave dhe grave të pa-favorizuar dhe promovim të mundësive të barabarta në tregun e punës.

Vlera e përgjithshme: 1.366.250 euro

Kohëzgjatja: 24 muaj (korrik 2015 - korrik 2017)

Shfrytëzuesi kryesor: Ministria për punë dhe politikë sociale. Më shumë

Projekte të kofinancuara nga BE-ja nën kompetencën e Ministrisë për vetëqeverisje lokale

Rrjeti tematik i qëndrueshëm i energjisë të autoriteteve ndërkufitare lokale - "ENERGYNET"

Financuar nga: Bashkimi Evropian dhe kofinancimi nacional, IPA program ndërkufitar mes Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë 2007 - 2013

Qëllim i projektit: menaxhim me pasojat nga ndryshimet klimatike mes rrjeteve të autoriteteve lokale në temë: "Energji e qëndrueshme" dhe "Hyrja e planifikimit të qëndrueshëm të energjisë në nivel komunal" në funksionimin e përditshëm.

Vlera e përgjithshme: 745.839,00 €

Buxheti për partnerët nga Republika e Maqedonisë: 267.285,00 €

Kohëzgjatja: Nëntor 2014 - Gusht 2016

Zbatuar nga Republika e Maqedonisë: 1 Komuna e Velesit, Komuna e Prilepit
Republika e Greqisë: 1. Komuna e Lerinit, 2. Komuna e Iraklisë, 3.Komuna e Vizaltisë.

Histori e gjallë - natyrë e gjallë II "LHI - LNA II"

Financuar nga: Bashkimi Evropian dhe kofinancimi nacional, IPA programi ndërkufitar mes Greqisë dhe Republikës së Maqedonisëv2007 - 2013.

Qëllim i Projektit: realizim i intervenimeve të përbashkëta nga ana e partnerëve me qëllim të mbrojtjes së burimeve historike dhe natyrore në fushën ndërkufitare me qëllim që vendet e zgjedhura të përdoren si mjete për promovuar karakteristikat e zonës mes zhvillimit të tre rrugëve lokale për funksionim të përditshëm. - "Rrugë të historisë së gjallë" dhe "Udhëkryqe të historisë dhe natyrës"

Vlera e përgjithshme: 729.370,00 €

Buxheti i partnerit të Republikës së Maqedonisë: 293.036,00 €

Kohëzgjatja: Nëntor 2014 - Gusht 2016

Zbatuar nga: Republika e Maqedonisë: komuna Novaci, Republika e Greqisë: komuna Meglen(Almopija)

Praktika inovative në mbrojtjen e mjedisit jetësor

Qëllim i përgjithshëm: mbështetja e menaxhimittë qëndrueshëm të burimeve të mjedisit jetësor në pellgun e Liqenit të Prespës dhe në rajonin e Korçës.
Qëllimi i aktivitetit është ti mbështes pilot praktikat për përmirësim të tretmanit dhe kualitetit të ujit në pellgun e Liqenit të Prespës dhe në rajonin e Korçës.
Financuar nga: Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Kohëzgjatja e projektit: projekti filloi në vitin 26.02.2014 dhe do të zgjas 20 muaj
Buxheti i përgjithshëm i projektit për grant shfrytëzuesit në Republikën e Maqedonisë është: 181.990,15 euro.
Buxheti i përgjithshëm i projektit për grant shfrytëzuesit në Shqipëri është: 175.266,00 euro
Lokacioni: Republika e Maqedonisë - Zona e Liqenit të Prespës, Resnja, Prespa dhe Galiçica. Shqipëri - Liqenas dhe Korçë
Zbatuar nga: Comitato di Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario (përfaqësia Prilep)- Republika e Maqedonisë dhe Destination Management Organization- Shqipëri
Partnerë: Komuna e Resnjës; Instituti publik Parku Nacional Galiçicë - Republika e Maqedonisë dhe Komuna Liçenac: Transborder Wildlife (TWA);Universiteti "Fan S. Noli" - Shqipëri.

Turizmi alternativ në Dibër

Qëllimi i përgjithshëm: Zhvillimi ekonomik lokal dhe rajonal, ndërkaq qëllimi specifik i projektit është të promovojë turizmin në Dibër nëpërmjet ndërtimit të rrugës së re për këmbësorë prej 2,2 km përgjatë bregut të Liqenit të Dibrës. Ndërtimi i kësaj infrastrukture, përpos liqenit do të sigurojë një bazë të mirë për tërhequr më shumë vizitorë. Vizitorët mund të gëzojnë aktivitetet e kohës së lirë si që janë: ecje, çiklizëm, vrapim.
Financuar nga: Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Kohëzgjatja e projektit: projekti filloi nga viti 11.12.2013 dhe do të zgjas 20 muaj
Buxhet i përgjithshëm i projektit për shfrytëzuesin e grantit në Republikën e **Maqedonisë është:** 238.320,00 euro
Lokacioni: Republika e Maqedonisë
Komuna: e Dibrës Shqipëri - Peshkopia
Partner: Komuna e Peshkopisë, Shqipëri

Lajme nga BE-ja

- Komisioni i Junkerit: Një vit më vonë
- Përfundim i Unionit ekonomik dhe Monetar : Komisoni ndërmor masa konkrete për fuqizimin e EMU
- Liderët u takuan për gjetjen e zgjidhjes për rritjen e fluksit të refugjatëve përgjatë rrugës së vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- Komisioni i Junkerit miratoi programin vjetor të dytë me radhë

- Udhëzime të reja për përdorim më të mirë të fondeve të BE-së: Komisioni i ndihmon shtetet anëtare për prokurimin publik
- Horizont 2020: program i ri për punë mbështet rritjen në Evropë. Vendet e punës dhe konkurrencën
- Mini samit për rrugën e migrimit në Ballkanin Perëndimor : Liderët u pajtuan për planin akcional me 17 pikë
- Delegacioni i Bashkimit Evropian hap konkurs për çmimin: Zhan Mone për vitin 2015
- Deklarata e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian - Frederika Mogerini, për t'i dhënë fund mosndëshkimit për veprat penale krime kundër gazetarëve, 2 nëntor 2015

A e dini se....?

- Çmimi Saharov për lirinë e të menduarit jepet çdo vjet nga ana e Parlamentit Evropian. Themeluar në vitin 1988 për nder të individëve dhe organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtat themelore.
- Çdo vit 400.00 raste të vdekjeve të hershme në BE janë si rezultat i ndotjes së ajrit
- 120 milion konsumator të BE-së duan ti rezervojnë aranzhimet e tyre turistike onlajn
- 100 miliard dollar në vit - janë paraparë për përmirësimin e klimës financiare deri me 2020

Datat e rëndësishme ndërkombëtare

- 10 nëntor - dita Botërore e shkencës për paqe dhe zhvillim
- 14 nëntor - Dita ndërkombëtare e diabetit
- 16 nëntor - Dita ndërkombëtare e tolerancës
- 21 nëntor - Dita botërore e televizorit
- 25 nëntor - Dita ndërkombëtare e eliminimit të dhunës kundër grave

Ju Falënderojmë